



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 5180 / Prot.
11

Tiranë, më 23 / 12 / 2021

URDHËR

Nr. 561, datë 23 . 12 . 2021

PËR

**MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT COVID-19, PËR
PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS PUBLIKE, PUNONJËSIT E SUPERMARKETEVE
DHE QENDRAVE TREGTARE**


Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 18, pika 7, të ligjit Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar, si dhe në zbatim të Vendimeve të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri Nr. 4881 datë 02.12.2021 dhe Nr. 5180 datë 23.12.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Punonjësit e administratës publike, punonjësit e supermarketeve dhe qendrave tregtare, si një ndër kategoritë që rrezikohen dhe përbëjnë rrezik për të tjerët, me qëllim për të penguar përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga Sars-Cov-2 (Covid-19), duhet të depozitojnë pranë qendrës së punës, duke filluar nga data 04.01.2022, një nga dokumentet e mëposhtme:
 - a) certifikatë vaksinimi Covid-19, të lëshuar nga e-Albania, që vërteton vaksinimin e plotë, në formë digjitale apo të printuar;
 - b) test PCR-je, çdo 5 ditë, të kryer sipas procedurës për kryerjen e testeve për efekte administrative, për të verifikuar që nuk janë mbartës të infeksionit Sars-Cov-2;
 - c) certifikatë shërimi Covid-19 të lëshuar nga e-Albania ose dokument të lëshuar nga autoritetet shëndetësore të vendit, që provon shërimin nga infeksioni Sars-Cov-2, me vlefshmëri deri në 6 muaj pas shërimit.
2. Përjashtim nga rregullat e përcaktuara në këtë urdhër bëhet vetëm për rastet që kanë indikacion mjekësor të përcaktuar me dokument mjekësor për mosaplikimin e vaksinës.

4. Ngarkohet Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik të bashkëpunojnë me institucionet e administratës publike dhe subjektet private që ushtrojnë aktivitet tregtar në supermarkete apo qendra tregtare, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



MINISTRI
Ogerta Manastirliu